



REPUBLIKA E KOSOVËS	REPUBLICA KOSOVA
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS	VRHOVNI SUD KOSOVA
G.J.A-Su.A	66/2016
Dt:	18.02.2016
PRISHTINË - PRIŠTINA	

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA  
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Date: 01.02.2016

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 01.02.2016 jep këtë:

#### Mendim juridik

Kur i pandehuri me veprim apo mosveprim ka konsumuar dy e më shumë vepra penale, prej të cilave, njëra është në kompetencë të Departamenti për të Mitur, ndërsa tjetra në kompetencë të Departamentit të Përgjithshëm - Departamenti për Krime të Rënda, apo kur disa të pandehur kanë kryer disa vepra penale, ku jo të gjitha bien në kompetencë të departamenti për të mitur, ndërsa bëhet fjalë për një akt akuzues, në rastet të tilla procedura parimisht do duhej të zhvillohej para departamentit përkatës sipas ligjit, mirëpo përjashtimisht mund të zhvillohet edhe një procedurë e përbashkët nga Departamenti i Përgjithshëm - Departamenti për Krime të Rënda, konform nenit 25. të KPK-s, mirëpo në raste të tillë, procedura në aspektin formal duhet të bashkohet me aktvendim.

#### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, në Gjykatën Supreme ka adresuar pyetjen: "Si duhet të procedohet, kur në një çështje penale disa të pandehur kanë konsumuar disa vepra penale (koneksiteti objektivo-subjektiv) nga të cilat, ndonjëra bie në kompetencë të Departamentit për të Mitur, ngase e dëmtuara është e mitur (*neni 145 të KPDM*), ndërsa tjerat në Departamentin e Përgjithshëm-për Krime të Rënda.

Kodi i procedurës penale, shprehimisht ka përcaktuar situatat, kur procedura mund të bashkohet dhe kur ajo mund të veçohet.

*Sipas nenit 36 par.5.të KPPK*, kur disa persona fajësohen për disa vepra penale, gjykata mund të vendos të zbatojë procedurë të bashkuar dhe të marrë një aktgjykim, me kusht që veprat të janë të ndërlidhura dhe provat të janë të përbashkëta.

Gjykata mund të vendosë të zbatojë procedurë të bashkuar dhe të marrë një aktgjykim, po që se, para të njëjtës gjykatë zbatohen procedura të ndara, kundër të njëjtit person, për disa vepra ose kundër disa personave, për vepër penale të njëjtë (par.7.)

Për bashkim të procedurës, vendos gjykata, e cila është kompetente për zbatimin e procedurës së bashkuar, në bazë të propozimit të prokurorit të shtetit ose sipas detyrës zyrtare. Kundër aktvendimit me të cilin caktohet bashkimi i procedurës ose refuzimi i propozimit për bashkim, nuk lejohet ankesë (par.8.).

*Sipas nenit 36.par.1.të KPPK-s, gjykata e cila sipas këtij Kodi është kompetente, për shkaqe të rëndësishme ose për arsyë të efikasitetit, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor mund të vendos veçimin e procedurave të zbatuara për disa vepra penale ose kundër disa të pandehurve.*

Sipas nenit 47 të KPDM, kur i mituri ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale me një të rritur, procedura gjyqësore kundër të miturit ndahet dhe zbatohet sipas dispozitave të këtij kodi. Në mënyrë të veçantë, procedura kundër të miturit mund të bashkohet me procedurën kundër të rriturit dhe mund të zbatohet në pajtim me dispozitat e përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, vetëm nëse bashkimi i procedurës është i nevojshëm për sqarim gjithëpërfshire të rastit. Trupi gjykues për të mitur i gjykatës kompetente merr vendim lidhur me këtë, në bazë të propozimit të arsyeshëm të prokurorit ose mbrojtësit. Palët mund të ushtrojnë ankesë kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë brenda tri (3) ditëve nga marrja e aktvendimit. 3. Kur procedura e bashkuar zbatohet kundër të miturit dhe kryerësit madhor, dispozitat e nenit 40, nenet 42 - 46, neni 48, neni 49, neni 50 paragrafët 1 dhe 3, neni 64 - 68 dhe neni 71 i këtij Kodi zbatohen gjithmonë lidhur me të miturin në rastet kur çështjet që kanë të bëjnë me të miturin sqarohen në shqyrtim gjyqësor dhe nenet 79 dhe 80 të këtij Kodi zbatohen gjithmonë lidhur me të miturin, ndërsa

dispozitat tjera të këtij Kodi zbatohen nëse aplikimi i tyre nuk është në kundërshtim me zbatimin e procedurës së përbashkët.

*Bazuar në faktin se edhe procedura ndaj të miturit*, kur dyshohet se ai ka kryer vepër penale me madhorët, mund të bashkohet me procedurën që zhvillohet ndaj madhorëve dhe në ato raste vlejnë dispozitat e përgjithshme të KPPK-s(me përjashtim të atyre dispozitave nga KPDPM, që domosdoshmërisht aplikohen ndaj të miturve), *nuk ekziston asnjë pengesë ligjore* që edhe kur madhorët kanë kryer disa vepra penale, e ndonjëra nga ato bie në kompetencë të Departamentit për të Mitur, procedura të bashkohet me procedurën e rregullt, e në ç'rast aplikohen dispozitat e përgjithshme të KPK-s, edhe përkitazi me përbërjen e trupit gjykues.

Prof. Dr. Fejzullah Hasani

Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës